

URDHËR
Nr. 276, datë 20.7.2026

PËR ADMINISTRIMIN E REGJISTRIT TË INSPEKTORËVE, NUMRIT UNIK TË IDENTIFIKIMIT DHE KARTËS SË INSPEKTORIT

(Ndryshuar me urdhrin nr. 276/1, datë 26.8.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 13, pika 1, germa “k”, nenit 47, të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 25, të VKM-së nr. 778, datë 19.12.2025, “Për përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin e rezultateve në punë, disiplinën, shkarkimin dhe lirin nga detyra të kryeinspektorit, inspektorit të inspektoratit qendror dhe inspektoratit të përgjithshëm”,

URDHËROJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky urdhër përcakton rregullat për krijimin, administrimin dhe funksionimin e Regjistrit të Inspektorëve, mënyrën e gjenerimit dhe administrimit të Numrit Unik të Identifikimit të Inspektorit (NUI), Numrit të Kartës së Inspektorit (NKI), si dhe procedurat për prodhimin, personalizimin, lëshimin, përdorimin, zëvendësimin, revokimin dhe verifikimin elektronik të Kartës së Inspektorit.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij urdhri është:

- a) krijimi i një sistemi unik për regjistrimin dhe identifikimin e inspektorëve;
- b) administrimi i Regjistrit të Inspektorëve në sistemin elektronik *e-Inspektimi*;
- c) garantimi i identifikimit unik dhe të përhershëm të çdo inspektori;
- ç) rregullimi i procedurave për gjenerimin dhe administrimin e Numrit Unik të Identifikimit (NUI) dhe Numrit të Kartës së Inspektorit (NKI);
- d) garantimi i administrimit të sigurt, të saktë dhe të përditësuar të të dhënave të inspektorëve;
- dh) mundësimi i identifikimit elektronik të inspektorëve gjatë ushtrimit të funksioneve inspektuese;
- e) garantimi i gjurmueshmërisë së historikut administrativ dhe profesional të inspektorëve.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Ky urdhër zbatohet nga:

- a) Inspektorati i Përgjithshëm, si autoritet përgjegjës për administrimin e Regjistrit të Inspektorëve dhe sistemit elektronik *e-Inspektimi*;
- b) institucionet inspektuese që ushtrojnë funksione inspektimi sipas legjislacionit në fuqi;
- c) çdo inspektor i regjistruar në Regjistrin e Inspektorëve.

Neni 4

Përkufizime

Për qëllime të këtij urdhri, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “**Regjistri i Inspektorëve**” është regjistri elektronik kombëtar që administrohet nga Inspektorati i Përgjithshëm nëpërmjet sistemit elektronik *e-Inspektimi*;
- b) “**Numri Unik i Identifikimit**” (NUI) është identifikuesi unik, personal dhe i pandryshueshëm i çdo inspektori;
- c) “**Numri i Kartës së Inspektorit**” (NKI) është identifikuesi unik i Kartës së Inspektorit, i lidhur elektronikisht me NUI;
- ç) “**Karta e Inspektorit**” është dokumenti zyrtar i identifikimit të inspektorit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij;
- d) “***e-Inspektimi***” është sistemi elektronik për administrimin e Regjistrit të Inspektorëve dhe të proceseve të identifikimit të inspektorëve;
- dh) “**Historiku elektronik**” është regjistrimi kronologjik i të gjitha veprimeve dhe ndryshimeve që lidhen me statusin e inspektorit, NUI dhe Kartën e Inspektorit.

KREU II

REGJISTRI I INSPEKTORËVE

Neni 5

Administrimi i Regjistrit të Inspektorëve

- 1. Regjistri i Inspektorëve administrohet nga Inspektorati i Përgjithshëm nëpërmjet sistemit elektronik *e-Inspektimi*.
- 2. Regjistri shërben për identifikimin unik të inspektorëve, administrimin e statusit të tyre, historikut profesional dhe të të dhënave të nevojshme për ushtrimin e funksioneve inspektuese.
- 3. Regjistri administrohet në mënyrë të centralizuar dhe garanton:
 - a) identifikimin unik të çdo inspektori;
 - b) integritetin dhe saktësinë e të dhënave;
 - c) ruajtjen e historikut të ndryshimeve;
 - ç) gjurmueshmërinë e veprimeve të kryera në sistem;
 - d) ndërveprimin me sistemet elektronike shtetërore, sipas legjislacionit në fuqi;
 - dh) administrimin e Numrit Unik të Identifikimit (NUI) dhe Numrit të Kartës së Inspektorit (NKI).
- 4. Inspektorati i Përgjithshëm është përgjegjës për administrimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Regjistrit të Inspektorëve.

Neni 6

Të dhënat që regjistrohen

1. Për çdo inspektor regjistrohen, të paktën këto të dhëna:

- a) emri;
- b) mbiemri;
- c) numri personal i identifikimit;
- ç) fotografia;
- d) institucioni inspektues;
- dh) drejtoria ose njësia organizative;
- e) funksioni;
- ë) fusha e inspektimit;

- f) data e emërimit;
- g) statusi;
- gj) Numri Unik i Identifikimit (NUI);
- h) Numri i Kartës së Inspektorit (NKI);
- i) statusi i kartës;
- j) data e lëshimit;
- k) adresa zyrtare e postës elektronike;
- l) të dhëna të tjera të nevojshme për administrimin e statusit të inspektorit, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Struktura e plotë e të dhënave të Regjistrit përcaktohet në shtojcën nr. 4, të këtij urdhri.

Neni 7

Regjistrimi dhe përditësimi i të dhënave

1. Institucioni inspektues është përgjegjës për regjistrimin fillestar të të dhënave të inspektorit në sistemin elektronik *e-Inspektimi*.

2. Çdo ndryshim në të dhënat e inspektorit regjistrohet në sistem pa vonesë dhe jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e hyrjes në fuqi të aktit administrativ që ka sjellë ndryshimin.

3. Përditësimi i të dhënave kryhet nga përdorues të autorizuar, sipas roleve dhe të drejtave të aksesit të përcaktuara nga Inspektorati i Përgjithshëm.

4. Inspektorati i Përgjithshëm monitoron saktësinë dhe plotësinë e të dhënave të regjistruara dhe, kur konstaton pasaktësi ose mospërputhje, kërkon korrigjimin e tyre nga institucioni përkatës.

5. Çdo ndryshim në të dhënat e regjistruara dokumentohet elektronikisht dhe shoqërohet me datën, orën dhe identifikimin e përdoruesit që ka kryer veprimin.

Neni 8

Historiku i Regjistrit të Inspektorëve

1. Regjistri i Inspektorëve ruan historikun e plotë të karrierës profesionale të çdo inspektori.

2. Historiku përfshin, në veçanti:

- a) regjistrimin fillestar;
- b) ndryshimet e institucionit inspektues;
- c) ndryshimet e funksionit;
- ç) ndryshimet e njësisë organizative;
- d) ndryshimet e fushës së inspektimit;
- dh) pezullimin ose rikthimin në detyrë;
- e) çaktivizimin e statusit të inspektorit;
- ë) lëshimin, zëvendësimin ose revokimin e kartës së inspektorit;
- f) të dhëna të tjera që lidhen me administrimin e statusit të inspektorit;
- g) ndryshimet e Numrit të Kartës së Inspektorit (NKI).

3. Historiku i regjistruar nuk mund të fshihet ose të zëvendësohet, por vetëm të plotësohet me të dhëna të reja, duke garantuar integritetin dhe gjurmueshmërinë e informacionit.

4. Të gjitha veprimet e kryera në Regjistrin e Inspektorëve regjistrohen automatikisht në *log-un* elektronik të sistemit *e-Inspektimi* dhe ruhen sipas rregullave për administrimin e dokumenteve elektronike.

KREU III

NUMRI UNIK I IDENTIFIKIMIT TË INSPEKTORIT (NUI)

Neni 9

Pajisja me Numrin Unik të Identifikimit

1. Çdo inspektor pajiset me Numrin Unik të Identifikimit (NUI) pas regjistrimit në Regjistrin e Inspektorëve dhe përpara pajisjes me Kartën e Inspektorit.
2. NUI gjenerohet automatikisht nga sistemi elektronik *e-Inspektimi*.
3. NUI është unik, personal dhe i përhershëm.
4. NUI përdoret për identifikimin e inspektorit në Regjistrin e Inspektorëve, në Kartën e Inspektorit dhe në sistemet elektronike që mbështesin veprimtarinë inspektuese.

Neni 10

Struktura e Numrit Unik të Identifikimit

1. NUI përbëhet nga elemente alfanumerike të gjeneruara automatikisht nga sistemi elektronik *e-Inspektimi*.
2. Struktura e NUI nuk përmban të dhëna personale ose elemente që identifikojnë institucionin, funksionin apo fushën e inspektimit.
3. Rregullat teknike për gjenerimin e NUI përcaktohen në shtojcën nr. 1, të këtij urdhri.

Neni 11

Administrimi i Numrit Unik të Identifikimit

1. NUI administrohet nga Inspektorati i Përgjithshëm nëpërmjet sistemit elektronik *e-Inspektimi*.
2. NUI lidhet elektronikisht me të gjitha të dhënat identifikuese dhe profesionale të inspektorit.
3. NUI nuk ndryshohet gjatë të gjithë periudhës në të cilën personi është i regjistruar në Regjistrin e Inspektorëve.
4. NUI nuk mund të përdoret nga një person tjetër.

Neni 12

Përditësimi i të dhënave

1. Ndryshimi i institucionit, funksionit, njësisë organizative ose fushës së inspektimit nuk sjell ndryshimin e NUI-t.
2. Në këto raste përditësohen vetëm të dhënat përkatëse në Regjistrin e Inspektorëve.
3. Çdo ndryshim regjistrohet në historikun elektronik të inspektorit.

Neni 13

Çaktivizimi i Numrit Unik të Identifikimit

1. NUI çaktivizohet kur inspektori humbet statusin e inspektorit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Pas çaktivizimit, NUI ruhet në Regjistrin e Inspektorëve dhe nuk mund t'i ricaktohet një personi tjetër.
3. Çaktivizimi i NUI-t nuk cenon ruajtjen e historikut administrativ dhe profesional të inspektorit.

Neni 14

Statusi i Numrit Unik të Identifikimit

1. Statusi i NUI-t në Regjistrin e Inspektorëve mund të jetë:
 - a) aktiv;
 - b) pezulluar;
 - c) çaktivizuar.
2. Në rast rikthimi në detyrë, NUI riaktivizohet, duke ruajtur të njëjtin identifikues unik dhe historikun administrativ.

KREU IV KARTA E INSPEKTORIT

Neni 15 Pajisja me Kartën e Inspektorit

1. Çdo inspektor pajiset me Kartën e Inspektorit pas pajisjes me Numrin Unik të Identifikimit (NUI).
2. Karta e Inspektorit është dokumenti zyrtar i identifikimit të inspektorit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij.
3. Karta prodhohet dhe personalizohet nga Inspektorati i Përgjithshëm nëpërmjet sistemit elektronik *e-Inspektimi*, sipas modelit të miratuar.
4. Karta është pronë e Inspektoratit të Përgjithshëm dhe përdoret vetëm nga mbajtësi i saj.

Neni 16 Numri i Kartës së Inspektorit (NKI)

1. Çdo Kartë Inspektori pajiset me një Numër të Kartës së Inspektorit (NKI), i gjeneruar automatikisht nga sistemi elektronik *e-Inspektimi*.
2. NKI-ja lidhet elektronikisht me NUI-n.
3. NKI-ja ndryshon vetëm në rast rilëshimi të Kartës së Inspektorit.
4. Ndryshimi i NKI-së nuk sjell ndryshimin e NUI-t.

Neni 17 Përmbajtja e Kartës së Inspektorit

1. Karta e Inspektorit përmban, të paktën:
 - a) stemën ose logon zyrtarë;
 - b) emrin dhe mbiemrin e inspektorit;
 - c) fotografinë;
 - ç) funksionin;
 - d) institucionin inspektues;
 - dh) Numrin e Kartës së Inspektorit (NKI);
 - e) kodin QR;
 - ë) elementet e sigurisë;
 - f) datën e lëshimit.
2. Modeli dhe specifikimet teknike të Kartës së Inspektorit përcaktohen në shtojcën nr. 2, të këtij urdhri.

Neni 18 Vlefshmëria e Kartës së Inspektorit

1. Karta e Inspektorit është e vlefshme për aq kohë sa mbajtësi i saj gëzon statusin e inspektorit.

2. Vlefshmëria e kartës verifikohet nëpërmjet sistemit elektronik *e-Inspektimi*.

3. Karta humbet vlefshmërinë në rastet e parashikuara në këtë urdhër ose në legjislacionin në fuqi.

Neni 19

Rilëshimi i Kartës së Inspektorit

1. Karta e Inspektorit rilëshohet, në rastet e:

a) humbjes ose vjedhjes së kartës;

b) dëmtimit ose kur karta është bërë e papërdorshme;

c) ndryshimit të emrit ose mbiemrit të inspektorit;

ç) ndryshimit të fotografisë zyrtare;

d) përmirësimit të elementeve teknike ose të sigurisë së kartës;

dh) çdo rasti tjetër kur rilëshimi është i nevojshëm për identifikimin e saktë të inspektorit.

2. Në rast rilëshimi, gjenerohet një NKI i ri, ndërsa NUI mbetet i pandryshuar.

3. Karta e mëparshme çaktivizohet automatikisht në sistemin elektronik *e-Inspektimi* dhe nuk mund të përdoret më për ushtrimin e funksioneve inspektuese.

Neni 20

Procedura e rilëshimit të Kartës së Inspektorit

1. Kërkesa për rilëshimin e Kartës së Inspektorit paraqitet nga institucioni inspektues ose nga inspektori pranë Inspektoratit të Përgjithshëm.

2. Pas verifikimit të kërkesës, Inspektorati i Përgjithshëm prodhon dhe lëshon kartën e re.

3. Çdo rilëshim regjistrohet në Regjistrin e Inspektorëve dhe në historikun elektronik të inspektorit.

Neni 21

Revokimi dhe çaktivizimi i Kartës së Inspektorit

1. Karta e Inspektorit revokohet dhe çaktivizohet në sistemin elektronik *e-Inspektimi* në rastet, kur:

a) inspektori humbet statusin e inspektorit;

b) përfundon marrëdhënia e punës;

c) karta është lëshuar mbi bazën e të dhënave të pasakta;

ç) konstatohet përdorim i paligjshëm ose keqpërdorim i kartës;

d) raste të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

2. Revokimi ose çaktivizimi regjistrohet menjëherë në sistemin elektronik *e-Inspektimi*.

3. Historiku i kartës së revokuar ruhet në Regjistrin e Inspektorëve dhe mbetet i aksesueshëm për qëllime administrative dhe auditimi.

KREU V

ADMINISTRIMI ELEKTRONIK

Neni 22

Verifikimi elektronik i Kartës së Inspektorit

1. Çdo Kartë Inspektori pajiset me një kod QR unik, i gjeneruar automatikisht nga sistemi elektronik *e-Inspektimi*.

2. Kodi QR shërben për verifikimin elektronik të vlefshmërisë së Kartës së Inspektorit dhe statusit të inspektorit në kohë reale.

3. Verifikimi elektronik realizohet nëpërmjet sistemit elektronik *e-Inspektimi*, duke mundësuar akses vetëm në të dhënat e nevojshme për identifikimin e inspektorit, sipas nivelit të autorizimit të përdoruesit.

4. Çdo verifikim regjistrohet automatikisht në sistem, duke garantuar gjurmueshmërinë e veprimeve të kryera.

5. Specifikimet teknike të kodit QR dhe procedurat e verifikimit elektronik përcaktohen në shtojcën nr. 3, të këtij urdhri.

KREU VI DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 23

Përgjegjësitë për zbatimin

1. Inspektorati i Përgjithshëm është përgjegjës, për:
 - a) administrimin e Regjistrit të Inspektorëve;
 - b) administrimin e sistemit elektronik *e-Inspektimi* në funksion të identifikimit të inspektorëve;
 - c) gjenerimin dhe administrimin e Numrit Unik të Identifikimit (NUI);
 - ç) prodhimin, personalizimin dhe administrimin e Kartës së Inspektorit;
 - d) administrimin e Numrit të Kartës së Inspektorit (NKI);
 - dh) garantimin e funksionimit, sigurisë dhe integritetit të sistemit.
2. Institucionet inspektuese janë përgjegjëse, për:
 - a) regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave të inspektorëve;
 - b) garantimin e saktësisë së të dhënave të regjistruara;
 - c) njoftimin pa vonesë të çdo ndryshimi që ndikon në statusin e inspektorit ose të Kartës së Inspektorit;
 - ç) administrimin e kartës së inspektorit gjatë marrëdhënies së punës.
3. Drejtoria e Vlerësimit të Riskut dhe Metodologjisë së Inspektimit në Inspektoratin e Përgjithshëm administron procedurat për prodhimin, personalizimin, shpërndarjen, zëvendësimin dhe revokimin e Kartës së Inspektorit.

Neni 24

Aktet zbatuese

1. Inspektorati i Përgjithshëm miraton, sipas nevojës, procedurat teknike dhe specifikimet funksionale për administrimin e Regjistrit të Inspektorëve, gjenerimin e identifikuesve unikë dhe prodhimin e Kartës së Inspektorit.
2. Katalogët e kodeve, modelet e dokumenteve, specifikimet teknike dhe shtojcat e këtij urdhri përditësohen me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm, kur kjo është e nevojshme për zbatimin e legjislacionit ose zhvillimin e sistemit elektronik *e-Inspektimi*, pa cenuar identifikuesit unikë të gjeneruar më parë.
3. Katalogët e kodeve përcaktohen në shtojcën nr. 5, të këtij urdhri.

Neni 25

Auditimi dhe siguria e sistemit

1. Sistemi elektronik *e-Inspektimi* regjistron automatikisht çdo veprim të kryer mbi Regjistrin e Inspektorëve, Numrin Unik të Identifikimit (NUI) dhe Kartën e Inspektorit.
2. Regjistrimet e auditimit (*Audit Log*) përmbajnë, të paktën:
 - a) identifikimin e përdoruesit;
 - b) datën dhe orën e veprimit;
 - c) llojin e veprimit të kryer;
 - ç) të dhënat e përditësuara;
 - d) rezultatin e veprimit.
3. Regjistrimet e auditimit ruhen sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe nuk mund të ndryshohen ose fshihen nga përdoruesit e sistemit.
4. Inspektorati i Përgjithshëm merr masat e nevojshme teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave.

Neni 26

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Përpunimi i të dhënave personale sipas këtij urdhri kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Aksesimi në Regjistrin e Inspektorëve dhe në sistemin elektronik *e-Inspektimi* lejohet vetëm për përdoruesit e autorizuar, sipas kompetencave të tyre.
3. Të dhënat përdoren vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë urdhër dhe nuk përpunohen në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 27

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij urdhri shfuqizohet urdhri nr. 32, datë 15.7.2016, “Për miratimin e modelit të kartës së inspektorit”, si dhe çdo akt tjetër që bie në kundërshtim me këtë urdhër.

Neni 28

Hyrja në fuqi

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
Dashnor Sula

SHTOJCA NR. 1

STRUKTURA DHE RREGULLAT E GJENERIMIT TË NUMRIT UNIK TË IDENTIFIKIMIT (NUI) (në zbatim të nenit 10 të urdhrit)

1. Qëllimi

Kjo shtojcë përcakton strukturën, rregullat e gjenerimit, administrimit dhe përdorimit të Numrit Unik të Identifikimit të Inspektorit (NUI).

2. Përkufizim

Numri Unik i Identifikimit (NUI) është identifikuesi elektronik unik, personal dhe i pandryshueshëm që gjenerohet nga sistemi elektronik *e-Inspektimi* dhe i caktohet çdo inspektori vetëm një herë.

3. Rregullat e gjenerimit

NUI:

- a) gjenerohet automatikisht nga sistemi elektronik;
- b) është unik për çdo inspektor;
- c) nuk mund të krijohet ose ndryshohet manualisht;
- ç) nuk mund të ripërdoret;
- d) ruhet gjatë të gjithë ciklit administrativ të inspektorit.

4. Struktura

NUI përbëhet nga një kombinim karakteresh alfanumerike me gjatësi fikse, të gjeneruara automatikisht nga sistemi elektronik. NUI ka formatin standard:

NUI-YYYY-NNNN

ku:

- a) **NUI** është kodi identifikues i strukturës së Numrit Unik të Identifikimit;
- b) **YYYY** është viti i regjistrimit të parë të inspektorit në Regjistrin e Inspektorëve dhe nuk përbën të dhënë të ndryshueshme të statusit të inspektorit;
- c) **NNNN** është numri rendor unik i gjeneruar automatikisht nga sistemi dhe nuk mund të ndryshohet ose ripërdoret.

Shembull: NUI-2026-00015

MODELI I REGJISTRIT TË NUI-t

Nr.	NUI	Emër	Mbiemër	IQ	Fusha	Funksioni	Data e regjistrimit	Statusi	Nr. rendor
1	NUI-2026-000001								
2	NUI-2026-000002								

5. Administrimi

NUI lidhet elektronikisht, me:

- Regjistrin e Inspektorëve;
- Kartën e Inspektorit;
- Numrin e Kartës së Inspektorit (NKI);
- Historikun administrativ të inspektorit.

SHTOJCA NR. 2

MODELI DHE SPECIFIKIMET E KARTËS SË INSPEKTORIT

(në zbatim të nenit 17, të urdhrin nr. 276, datë 20.7.2026)

(Zëvendësuar me urdhrin nr. 276/I, datë 26.8.2026)

1. Numri i Kartës së Inspektorit (NKI)

NKI përbëhet nga elementet e mëposhtme:

Emërtimi i shkurtuar i IQ-së	Kodi i IQ-së	Kodi i drejtorisë së përgjithshme/rajonale	Numri rendor i gjeneruar automatikisht
ISHPSHSH	01	01	0001

Shembull: ISHPSHSH-0101-0001

2. Ana e përparme:

- stemën e Republikës së Shqipërisë;
- ministrinë përgjegjëse;
- inspektoratin qendror;
- drejtorinë rajonale, nëse ka;
- fotografinë;
- emrin;
- mbiemrin;
- funksionin;
- institucionin;
- Numrin e Kartës së Inspektorit (NKI);
- datën e lëshimit;
- kodin QR.

3. Ana e pasme:

- Ky dokument identifikon inspektorin;
- Mbajtësi i tij ushtron detyrat sipas ligjit nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;
- Ky dokument është pronë e institucionit dhe duhet të kthehet menjëherë në përfundim të marrëdhënies së punës ose kur kërkohet nga organet kompetente;
- Inspektori i Përgjithshëm - firma dhe vula.

MODELI I KARTËS SË INSPEKTORIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËRGJEGJËSE
INSPEKTORATI QËNDROR
DREJTORIA RAJONALE (NËSE KA)



EMER MBIEMER
FUNKSIONI

INSPEKTORATI QENDROR

EMËRTIMI I SHKURTUAR I IQ-KODI IQ-KODI
DREJTORI PËRGJITHSHME/RAJONALE-NR
RENDOR

DATA E LËSHIMIT
DD.MM.2026



INSPEKTORATI I PËRGJITHSHËM

 Ky dokument identifikon Inspektorin.

 Mbajtësi i tij ushtron detyrat sipas Ligjit nr. 99/2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

 Ky dokument është pronë e institucionit dhe duhet të kthehet menjëherë në përfundim të marrëdhënies së punës ose kur kërkohet nga organet kompetente.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
DASHNOR SULA



 Adresa: Kompleksi Delijorgji, Rr. M. Llagami, Tiranë

 Tel: 042 229765
042 229883

 www.ip.gov.al
info@ip.gov.al

Në rast gjetjeje, ju lutem ta dorëzoni pranë Inspektoratit të Përgjithshëm ose njoftoni numrin e telefonit të institucionit.

SHTOJCA NR. 3

SPECIFIKIMET E KODIT QR DHE PROCEDURAT E VERIFIKIMIT ELEKTRONIK

(në zbatim të nenit 22 të urdhrit)

1. Kodi QR

Çdo Kartë Inspektori përmban një kod QR unik.

2. Funksioni

Kodi QR përdoret, për:

- a) verifikimin e vlefshmërisë së kartës;
- b) verifikimin e statusit të inspektorit;
- c) identifikimin elektronik.

3. Përmbajtja

Kodi QR nuk përmban të dhëna personale.

Ai përmban vetëm identifikuesin teknik që mundëson lidhjen me sistemin *e-Inspektimi*.

4. Verifikimi

Pas skanimit të kodit QR sistemi shfaq:

- a) emrin dhe mbiemrin;
- b) institucionin;
- c) funksionin;
- d) statusin e kartës.

5. Siguria

Kodi QR nuk mund të modifikohet.

Çdo verifikim regjistrohet në *Audit Log*.

SHTOJCA NR. 4

STRUKTURA E REGJISTRIT TË INSPEKTORËVE DHE FUSHAT E TË DHËNAVE

(në zbatim të nenit 6 të urdhrit)

1. Qëllimi

Kjo shtojcë përcakton strukturën minimale të Regjistrit të Inspektorëve dhe të dhënat që administrohen në sistemin elektronik *e-Inspektimi*.

2. Të dhënat identifikuese

Nr.	Të dhënat
1	Numri Unik i Identifikimit (NUI)
2	Emri
3	Mbiemri
4	Numri personal
5	Fotografia zyrtare
6	Institucioni inspektues
8	Njësia organizative
9	Funksioni
10	Fusha kryesore e inspektimit
11	Data e emërimit
12	Data e regjistrimit
13	Statusi i inspektorit
14	Numri i Kartës së Inspektorit (NKI)
15	Data e lëshimit të kartës
16	Statusi i kartës
17	Adresa elektronike zyrtare
18	Historiku i transferimeve
19	Historiku i kartave
20	Shënime administrative

3. Të dhënat institucionale

Nr.	Fusha
-----	-------

1	Institucioni inspektues
2	Kodi i institucionit
3	Drejtoria
4	Sektori/njësia organizative
5	Pozicioni i punës
6	Funksioni
7	Dega rajonale

4. Të dhënat profesionale

Nr.	Fusha	
1	Fusha kryesore e inspektimit	
2	Fusha dytësore e inspektimit (nëse ka)	
3	Data e emërimit	
4	Data e fillimit të ushtrimit të funksionit	
5	Statusi i inspektorit	
6	Data e regjistrimit në Regjistër	

5. Të dhënat e identifikimit elektronik

Nr.	Fusha
1	Numri Unik i Identifikimit (NUI)
2	Numri i Kartës së Inspektorit (NKI)
3	Statusi i kartës
4	Data e lëshimit të kartës
5	Data e skadimit të kartës
6	QR Code
7	Identifikuesi elektronik i kartës

6. Të dhënat e kontaktit

Nr.	Fusha
1	<i>Email-i</i> zyrtar
2	Numri i telefonit zyrtar (nëse administrohet)

7. Statusi administrativ

Kodi	Statusi
A	Aktiv
P	Pezulluar
T	Transferuar
L	Larguar nga funksioni
Ç	Çaktivizuar

8. Historiku profesional

Për çdo inspektor regjistrohen:

- regjistrimi fillestar;
- emërimi;
- konfirmimi në detyrë;
- transferimet;
- ndryshimi i institucionit;
- ndryshimi i funksionit;
- ndryshimi i njësisë organizative;
- ndryshimi i fushës së inspektimit;
- pezullimi;
- rikthimi në detyrë;
- përfundimi i marrëdhënieve të punës;
- çaktivizimi i statusit;
- lëshimi i kartës;
- rilëshimi i kartës;
- zëvendësimi i kartës;
- revokimi i kartës.

9. Të dhënat e *Audit Log*

Për çdo veprim sistemi regjistron automatikisht:

Nr.	Fusha
1	Data
2	Ora
3	Përdoruesi
4	Institucioni
5	Veprimi i kryer
6	Objekti i ndryshimit
7	Adresa IP (kur administrohet)
8	Komenti i sistemit

SHTOJCA NR. 5

KATALOGËT DHE KLASIFIKIMET E SISTEMIT ELEKTRONIK E- INSPEKTIMI

(në zbatim të nenit 24 të urdhrit)

1. Qëllimi

Kjo shtojcë përcakton katalogët standardë që përdoren nga sistemi elektronik e-
Inspektimi për administrimin e Regjistrit të Inspektorëve.

2. Katalogu i institucioneve inspektuese

Përmban:

- kodin;
- emërtimin;
- llojin e institucionit;
- statusin.

3. Katalogu i fushave të inspektimit - Përmban fushat sipas legjislacionit sektorial.

Nr.		Inspektoratet qendrore	KODI I IQ-së	Fushat e inspektimit	Kodi i fushës së inspektimit
1	ISHPSHSH-ja	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore	Kodi 01	1. Inspektimi në punë	Kodi 01
2	AKU-ja	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	Kodi 02	1. Inspektimi i OBU-së me origjinë shtazore;	Kodi 02
				2. Inspektimi i OBU-së me origjinë jo shtazore;	Kodi 03
				3. Inspektimi i mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore;	Kodi 04
				4. Inspektim për IPARD-in;	Kodi 05
				5. Plani i monitorimit të qumështit lëndë e parë (Prodhim Primar);	Kodi 06
3	AKM-ja	Agjencia Kombëtare e Mjedisit	Kodi 03	6. Materiale në kontakt me ushqimin.	Kodi 07
				1. Inspektim në ujëra;	Kodi 08
4	AKAP-i	Agjencia Kombëtare e Arsimit	Kodi 04	2. Inspektim në mjedis.	Kodi 09
				1. Inspektimi në arsimin parashkollor (kopshtet);	Kodi 10

		Parauniversitar		2. Inspektimi në arsimi bazë (arsimi fillor dhe arsimi i mesëm i ulët);	Kodi 11
				3. Inspektimi në arsimin e mesëm dhe të lartë;	Kodi 12
				4. Inspektim për pajtueshmërinë e veprimtarisë së ZVAP-së me aktet ligjore dhe nënligjore;	Kodi 13
				5. Inspektim në Shkollën e Bashkuar.	Kodi 14
5	ISHTI	Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial	Kodi 05	1. Inspektimi i gazit dhe i naftës;	Kodi 15
				2. Inspektimit i pajisjeve nën presion;	Kodi 16
				3. Inspektimi i pajisjeve dhe instalimeve elektrike;	Kodi 17
				4. Transmetim shpërndarjeje, tregtim, depozitim, ndërtim e operim të infrastrukturës së gazit natyror.	Kodi 18
6	ISHSH-ja	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor	Kodi 06	Inspektime të tjera shëndetësore;	Kodi 19
				Inspektim sanitar;	Kodi 20
				Inspektimi shëndetësor;	Kodi 21
				Inspektim për akreditim.	Kodi 22
7	ZMR-ja	Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet	Kodi 07	Inspektimi për Aparaturat me rreze X;	Kodi 23
				Inspektimi i burimeve radioaktive të hapura;	Kodi 24
				Inspektimi për burime të mbyllura;	Kodi 25
				Inspektimi për subjektet që kryejnë transport të lëndëve radioaktive.	Kodi 26
8	AKSEM-i	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat Minerare	Kodi 08	1. Inspektimi në sipërfaqe;	Kodi 27
				2. Inspektimi në nëntokë.	Kodi 28
9	ISHMT-ja	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut	Kodi 09	E drejta e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to;	Kodi 29
				Inspektimi për të drejtat e pronësisë industriale;	Kodi 30
				Inspektimi i detergjenteve;	Kodi 31
				Inspektim për mbrojtjen e konsumatorëve;	Kodi 32
				Inspektim i pajisjeve elektrike;	Kodi 33
				Inspektime të produkteve-instalimeve mekanike;	Kodi 34
				Inspektimi për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore;	Kodi 35
				Inspektimi metrologjik;	Kodi 36
				Inspektimi i produkteve qelq-këpucë-sig. produkteve;	Kodi 37

				Inspektimi i artikujve piroteknik;	Kodi 38
				Inspektimi i qeseve plastike mbajtëse.	Kodi 39
10	IKMT-ja	Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit	Kodi 10	Inspektime në mjedis dhe në ujëra	Kodi 40
				Inspektim në pyje	Kodi 41
				Inspektim në ndërtim	Kodi 42
11	AKBPM-ja	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	Kodi 11	Inspektimi i depove farmaceutike;	Kodi 43
				Inspektimi i farmacive private;	Kodi 44
				Inspektimi i farmacive spitalore;	Kodi 45
				Inspektim fabrikuesit e barnave;	Kodi 46
				Inspektim depo e pajisjeve mjekësore.	Kodi 47
12	DSHPA-ja	Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (DSHPA)	Kodi 12	1. Inspektimi në peshkim;	Kodi 48
				2. Inspektimi në Akuakulturë;	Kodi 49
13	DPA-ja	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	Kodi 13	1. Inspektim për zbatimin e detyrave në sekretari/arkiv;	Kodi 50
				2. Për licencimin e arkivave privatë;	Kodi 51
				3. Inspektimin në arkivat e sistemit dhe tipologjisë.	Kodi 52
14	AKB-ja	Agjencia Kombëtare e Bregdetit	Kodi 14	Inspektim në turizëm.	Kodi 53
15	AKZM-ja	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura	Kodi 15	1. Inspektimi për zonat e mbrojtura.	Kodi 54
16	AKVMB-ja	Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve	Kodi 16	Inspektime në farmaci veterinare;	Kodi 55
				Inspektime në depo farmaceutike veterinare;	Kodi 56
				Inspektime në ferma gjedhi mbi 5 krerë;	Kodi 57
				Inspektime në ferma të imta mbi 70 krerë;	Kodi 58
				Inspektime në stabilimentet e derrave;	Kodi 59
				Inspektime në stabilimentet e shpendëve;	Kodi 60
				Inspektime në stabilimentet e akuakulturës;	Kodi 61
				Inspektime të parqeve me bletë mbi 50 krerë;	Kodi 62
				Inspektime në tregjet e kafshëve të gjalla;	Kodi 63
				Inspektime të subjekteve që tregtojnë produktet me origjinë shtazore.	Kodi 64

4. Katalogu i strukturave organizative

Përmban:

- drejtoritë;
- sektorët;
- njësitë.

5. Katalogu i funksioneve

Përmban:

- Kryeinspektor;
- inspektor;
- funksione të tjera të miratuara.

6. Administrimi i katalogëve

1. Katalogët administrohen nga Inspektorati i Përgjithshëm nëpërmjet sistemit elektronik *e-Inspektimi*.

2. Përditësimi i katalogëve kryhet me miratimin e Inspektorit të Përgjithshëm, kur është i nevojshëm për zbatimin e legjislacionit ose zhvillimin e sistemit elektronik.